

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019, “Për Rininë”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Faza Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	VKM nr.692, datë 26.10.2022 “Strategjisë Kombëtare e Rinisë dhe plani i veprimit 2022-2029”
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	27.11.2024- 25.12.2024
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	15.1. 2025
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2025- MSHRF – Nr.1 VN
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Sara Kapoli, sara.kapoli@kryeministria.al Nr. tel: 0696636653 Oltion Pengu oltion.pengu@kryeministria.al Nr. tel: 0684037864
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i>	
Problemi në shqyrtim lidhet me mangësitë në kuadrin ligjor që mbështet dhe promovon drejtat dhe mundësitë për zhvillimin e të rinjve në Shqipëri. Ligji nr. 75/2019 "Për Rininë" nuk garanton përfaqësimin gjithëpërfshirës të të rinjve, nuk parashikon mekanizmat e nevojshëm për sigurimin e cilësisë së shërbimeve rinore dhe punës me të rinjtë, dhe nuk trajton në mënyrë të përshtatshme nevojat specifike të grupeve të marginalizuara dhe të privuar së të rinjve. Si pasojë, të rinjtë përballen me pengesa të mëdha për përfshirjen e tyre në jetën publike, sociale dhe ekonomike dhe për përfitimin nga politikat rinore publike. Rregullimet aktuale ligjore nuk garantojnë mbështetjen e nevojshme për krijimin dhe mirëfunksionimin e qendrave rinore në çdo bashki të vendit. Si kundër, mekanizmat ligjore, të ngritura për pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse, si Këshilli Kombëtar i Rinisë (KKR) dhe Këshillat Vendorë të Rinisë (KVR), rezultojnë shpeshherë të paefektshëm	

për të ndikuar politikat rinore qendrore dhe vendore, dhe për të promovuar interesat e të rinjve, në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Shkaqet e Problemit

Disa nga shkaqet kryesore që kanë sjellë këtë situatë janë:

1. Kuadri ligjor ofron rregullime të pamjaftueshme dhe përkufizime të paqarta ligjore:

- Ligji aktual ofron përkufizime të paqarta mbi organizatën rinore dhe përgjegjësitë e njësive të vetë qeverisjes vendore për mbrojtjen dhe mbështetjen e të rinjve.
- Ligji aktual nuk ofron rregullime të përshtatshme për mbështetjen e organizmin dhe aktivizimin e të rinjve, veçanërisht në bashkitë e vogla dhe zonat rurale, ku evidentohet mungesa e pranisë së organizatave rinore dhe për të rinj.
- Ligji aktual nuk ofron përcaktime mbi punonjës të rinor si dhe për kompetencat dhe kualifikimet që duhet të zotërojë personi që kryen punën rinore.

2. Mundësimi i shërbimeve rinore është i cunguar dhe i paqëndrueshëm:

- Qendrat rinore mungojnë në shumë bashki dhe aty ku funksionojnë, dëshmojnë burime të kufizuara njerëzore dhe logjistike për të mundësuar shërbime rinore dhe punën rinore cilësore.
- Evidentohet bashkëveprim i ulët dhe sporadik midis bashkive dhe organizatave rinore/për të rinjtë në përdorimin e infrastrukturës rinore në potencialin e plotë të saj.
- Mungon kuadri i plotë dhe efektiv për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të qendrave rinore dhe nuk ka standarde bazë për sigurimin e cilësisë dhe mirëfunksionimin e tyre në mbarë vendin.

3. Politikat dhe veprimtaritë rinore nuk janë gjithëpërfshirëse:

- Evidentohet nivel i ulët i përfshirjes dhe përfitimit nga politikat dhe veprimtaritë rinore të të rinjve që i përkasin grupeve të marginalizuara, përfshirë atyre nga zonat rurale, komunitetet rom dhe egjiptian, të rinjve me aftësi të kufizuara dhe të rinjve nuk janë në punësim, arsim ose formim profesional, duke dëshmuar efektivitet të ulët në adresimin e nevojave të tyre të posaçme.

Nevoja për Ndërhyrjen e Qeverisë:

Ndërhyrja e qeverisë është e domosdoshme për të adresuar mangësitë dhe paqartësitë e identifikuara në kuadrin ligjor aktual. Pa rishikimin e ligjit, të rinjtë e vendit do të vazhdojnë të përballen me mundësi të kufizuara për zhvillimin personal, aktivizim shoqëror dhe pjesëmarrje në vendimmarrje, si dhe me një kuadër institucional dhe mekanizma mbështetje jo efektive.

Ndërhyrja e qeverisë do të ndihmojë gjithashtu në harmonizimin e politikave rinore me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë praktikën më të mirë të Bashkimit Evropian në fushën e rinisë. Përmes ndryshimit të ligjit, Shqipëria do të mund të krijojë një kuadër të fortë ligjor që garanton mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesore të këtij propozimi janë:

- Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse, në përputhje me rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare në këtë fushë. Kjo do të realizohet përmes:
 - Harmonizimit dhe racionalizimit të përbërjes së Këshillave Rinore Vendore bazuar në kritere objektive dhe të unifikuara në shkallë vendi. Rregullimi i ri do lehtësojë mirëfunksionimin e këtyre forumeve dhe rrisë efektivitetin e programeve për rritjen e kapaciteteve të tyre të zbatuara nga institucioni përgjegjës për rininë dhe donatorët e huaj.
 - Rritjes së përfaqësimit të garantuar për të rinjtë brenda strukturave konsultative, si Këshilli Kombëtar i Rinisë dhe Këshillin Vendor të Rinisë nga një e dyta, në dy të tretat e numrit të anëtarëve.
 - Detyrimit të “bashkëkryesimit” të Këshillit Kombëtar të Rinisë dhe Këshillit Vendor të Rinisë, nga zyrtari më i lartë shtetëror qendror dhe vendor në fushën e rinisë dhe përfaqësuesi i zgjedhur mes të rinjve në këto forume, në përputhje me praktikën më të mira europiane, duke forcuar rolin dhe përgjegjësitë e të rinjve brenda këtyre forumeve, pa cenuar efektivitetin e tyre.
 - Rritjes së funksionalitetit dhe efektivitetit të veprimtarisë së KKR-së dhe KVR-ve, përmes rritjes së mundësive për mbështetjen e veprimtarisë së tyre nga burime të ndryshme financiare.
- Zbatimi i politikave të reja për mbështetjen dhe aktivizimin e të rinjve, përmes:
 - Ngritjes së Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, që i mundëson të rinjve një përvojë kualifikuese profesionale në institucionet e administratës shtetërore, duke garantuar mbikëqyrjen, trajnimin dhe trajtimin ushqimor për to gjatë praktikës dhe punësimin përmes kontratave të përkohshme të punës të të rinjve me vlerësimin më të lartë.
 - Ngritjes së programit të talenteve rinore që mbështet kultivimin dhe promovimin e talenteve të të rinjve në fushat e artit, kulturës, edukimit, shkencës, teknologjisë dhe sportit, duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në kompeticione dhe veprimtarë zyrtarë ndërkombëtarë dhe dhënies së shpërblimeve bazuar në vlerësimin dhe rezultatet e arritura prej tyre.
 - Projekteve me impakt komunitar të zbatuara nga grupimet joformale të të rinjve dhe këshillat vendor rinor, të mbështetura nga fondi grant i dedikuar për rininë.
- Krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, në përmbushjen e potencialit të tyre në interes të shoqërisë. Kjo do të arrihet përmes:
 - Përfaqësimit të garantuar brenda Këshillit Kombëtar i Rinisë dhe Këshilli Vendor i Rinisë, i të rinjve nga grupet e marginalizuara, të rinjve me nevoja të veçanta, të rinjve shqiptarë nga diaspora dhe të rinjve të grup moshës 15-18 vjeç, me qëllim që vendimmarrja në fushën e rinisë të reflektojë në mënyrë më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse interesat dhe perspektivat e të rinjve.
 - Mbështetjes dhe fuqizimit të të rinjve, bazuar mbi parimin e gjithëpërfshirjes, duke siguruar përshtatjen dhe synimin e posaçëm të politikave rinore në plotësimin e kushteve

shoqërore, financiare dhe fizike për zhvillimin personal dhe pjesëmarrjen në jetën publike, sociale, ekonomike dhe kulturore të rinjve, që i përkasin grupeve të marginalizuara, me nevoja të veçanta, me akses të kufizuar në shërbime dhe burime dhe të rinjve jo në punësim, arsim ose formim profesional.

- Njohjes dhe mbështetjes së grupeve joformale të të rinjve, si një formë më e thjeshtuar dhe me më pak barriera e organizimit rinor, që do të nxisë më tej organizmin dhe aktivizimin e të rinjve në adresimin e problemeve në komunitetin e tyre vendor, veçanërisht në bashkitë e vogla dhe zonat rurale, ku evidentohet mungesa e pranisë së organizatave rinore dhe për të rinj.
- Vendosjes së standardeve dhe rritjes cilësisë në shërbimet e ofruara për të rinjtë dhe punës rinore, përmes:
 - Ngritjes së qendrave rinore si person juridik, duke forcuar bashkëpunimin mes bashkive dhe organizatave rinore/për të rinjtë me qëllim mirëfunksionimin, rritjes së qëndrueshmërisë financiare të tyre dhe mbështetur ngritjen e tyre në të gjithë bashkitë e vendit.
 - Vendosjes së standardeve bazë për strukturimin, rolin, funksionet, sigurinë dhe ofrimin e shërbimeve të qendrave rinore.
 - Njohjes dhe përcaktimit të kompetencave të punonjësve rinorë dhe masave mbështetëse për ngritjen e programeve për formimin e punonjësve rinore dhe kualifikimin e vazhduar të tyre.
- Rregullimi dhe qartësimi e parashikimeve ligjore me qëllim rritjen e efektivitetit dhe zbatueshmërisë së tij, përmes:
 - Saktësimi të kriterëve për përcaktimin e organizatave rinore që janë pa anëtarësi, në harmoni me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse.
 - Qartësimi të përgjegjësisë së bashkisë për mbështetjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në nivel vendor, në harmoni me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore.
 - Përcaktimit të përgjegjësisë së ministrisë për rininë për monitorimin e standardeve të mirëfunksionimit të qendrave rinore.
 - Ngritjes së një komisioni të specializuar për vlerësimin e propozimeve që do mbështeten përmes fondit grant për rininë, duke siguruar efektivitet të lartë në shpërndarjen fondeve dhe rritur sinergjinë mes ndërhyrjeve të aktoreve të ndryshëm rinor që mbështeten prej tij.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të disavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0: – Të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues e konkretisht me ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”. Pra ruajtja “status quo”-së (duke mos ndërhyrë me ndryshime, në ligjin ekzistues dhe duke mos hartuar një projektligji të ri).

- **Avantazhet:**

- Nuk krijon kosto shtesë financiare për institucionet publike.
- Nuk kërkon burime të reja për ndryshime të kuadrit rregullator dhe administrativ.

- **Disavantazhet:**

- Problemet aktuale si përkufizimet e paqarta mbi organizatat rinore pa anëtarësi dhe përgjegjësitë e bashkisë mbeten të pazgjidhura.
- Nuk forcon dhe përmirëson mekanizmat për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve.
- Pengon vendosjen e standardeve dhe sigurimin e cilësisë në shërbimet e ofruara për të rinjtë dhe punës rinore.
- Pengon zbatimin e politikave të reja për mbështetjen dhe aktivizimin e të rinjve.

Opsioni 1: Shfuqizimi i ligjit aktual dhe miratimi i projektligjit të ri “Për Rininë”.

- **Avantazhet:**

- Nuk ka.

- **Disavantazhet:**

- Ka kosto të lartë dhe nevojë për burime financiare dhe njerëzore të qenësishme.
- Nuk është efikas për sa kohë ndryshimet e propozuara nuk prekin më shumë se 50% të përmbajtjes së ligjit aktual.
- Ngritja e kuadrit të ri ligjor kërkon kohë të gjatë, duke ndikuar negativisht në sektorin e rinisë dhe duke pamundësuar mekanizmat e ngritura për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve.
- Krijon pasiguri ligjore midis organizatave rinore/për të rinjtë, institucioneve shtetërore dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në fushën e rinisë.

Opsioni 2 (i preferuar): Ndryshimi i ligjit aktual, pra i ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”.

- **Avantazhet:**

- Përmirëson kuadrin ligjor ekzistues pa e shfuqizuar atë, duke ruajtur stabilitetin e rregullimeve të tanishme.
- Adreson të gjitha problematikat e evidentuara në ligjin aktual në mënyrë efektive dhe të plotë.
- Lejon zbatimin në mënyrë të shpejtë dhe të përshtatshme të politikave të reja në mbështetje të rinisë.
- Harmonizohet me praktikat dhe standardet ndërkombëtare, veçanërisht ato të BE-së.

- **Disavantazhet:**

- Krijon kosto shtesë financiare për institucionet publike krahasuar me opsionin 0.
- Kërkon burime të reja për ndryshime të kuadrit rregullator dhe administrativ krahasuar me opsionin 0.

Përfundim:

Ndryshimi i ligjit aktual, pra i ligjit nr.75/2019 “Për Rininë, është opsioni më i përshtatshëm që siguron përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues në mënyrë efektive dhe të plotë dhe që siguron zbatimin në mënyrë të shpejtë dhe të përshtatshme të politikave të iniciuara në mbështetje të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të të rinjve.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike

Vënia në zbatim e opsionit të preferuar do të shoqërohet me ndikime ekonomike.

Për sa më sipër financimi i kostove të Programit të Talenteve të Reja, Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, Grupeve joformale rinore, Komisionit të vlerësimit të kërkesave dhe financimi i veprimtarisë së Këshillave Vendore Rinore dhe Këshillit Kombëtar të Rinisë do të përballohen nga fondet grant të dedikuara për rininë, buxheti i Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe burime të tjera të ligjshme, sipas përcaktimeve të ligjit “Për Rininë” dhe vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave. Financimi për periudhën 2025-2027 është planifikuar brenda tavanëve të programit mbështetje për rininë dhe fëmijët, me shuma të miratuara për çdo vit. Për vitin 2025 janë parashikuar 50,000,000 lekë, për vitin 2026 janë parashikuar 50,000,000 lekë dhe për vitin 2027 janë parashikuar 50,000,000 lekë.

Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin për Rininë pritet të ketë ndikime ekonomike pozitive, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë lokal. Ndikimet ekonomike përfshijnë:

a) Përmirësimi i Aftësive dhe Kualifikimeve Profesionale i të Rinjve

Miratimi i Programit Kombëtar të Praktikave të Punës dhe ngritja e programeve profesionale për formimin e punonjësve rinorë do të mbështesë të rinjtë dhe profesionistët që do punojnë me të rinjtë të zhvillojnë aftësi të reja dhe të rrisin kualifikimet e tyre profesionale. Kjo do të ndikojë në rritjen e produktivitetit në tregun të punës dhe në rritjen e perspektivës profesionale dhe rritjen e të ardhurave individuale dhe familjare.

b) Zhvillimi i Ekonomisë Vendore

Mbështetja për projektet me impakt komunitar të zbatuara nga grupet rinore joformale dhe këshillat rinore vendore do të ndikojnë zhvillimin e ekonomisë vendore, sidomos në bashkitë e vogla dhe zonat rurale. Kjo përfshin zhvillimin e projekteve në bujqësi dhe zhvillim rural, kulturë, teknologjisë dhe inovacionit, të cilat krijojnë mundësi të reja angazhimi për të rinjtë.

c) Rritja e Investimeve buxhetore dhe jo buxhetore në fushën e Rinisë

Projektligji krijon baza ligjore për rritjen e investimeve buxhetore dhe jo buxhetore në ngritjen dhe operimin e qendrave rinore dhe në programet që mbështesin të rinjtë. Kjo do të sjellë përfitime afatgjata për ekonominë e vendit duke krijuar një brez të rinjsh më të kualifikuar dhe të aftë dhe të integruar në jetën sociale dhe ekonomike të vendit.

Ndikimet sociale

Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 "Për Rininë" pritet të ketë ndikime sociale të rëndësishme për të rinjtë dhe komunitetet ku ata jetojnë. Ky projektligj do të sjellë përfitime sociale afatgjata për shoqërinë shqiptare, duke përfshirë:

- Përmirësimin e pjesëmarrjes qytetare të të rinjve.
- Rritjen e mundësive për zhvillimin personal dhe profesional të të rinjve.
- Përmirësimin e cilësisë së jetës për grupet e të rinjve me nevoja të veçanta dhe me privime.
- Rritjen e ndërgjegjësimit për çështje sociale dhe mjedisore.
- Nxitjen e një kulture të solidaritetit dhe bashkëpunimit në komunitete.

Ndryshimet e propozuara në Ligjin për Rininë do të kenë ndikime pozitive në përmirësimin e pjesëmarrjes, përfshirjes dhe mirëqenies së të rinjve në vend. Përmes një zbatimi të suksesshëm të projektligjit, do të krijohen mundësi të reja për të rinjtë për të kontribuar në zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të vendit. Këto ndryshime do të ndihmojnë në krijimin e një shoqërie më të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt të ardhmes.

Ndikimet sociale të drejtpërdrejta përfshijnë:

a) Përmirësimi i Pjesëmarrjes së të Rinjve në Vendimarrje

Ndryshimet në projektligj synojnë të rrisin pjesëmarrjen e të rinjve në proceset politikbërëse dhe vendimarrëse në nivel qendror dhe lokal. Përmes rritjes së përfaqësimit në Këshillat Rinorë Vendore dhe në Këshillin Kombëtar të Rinisë, të rinjtë do të kenë mundësi më të mëdha për të ndikuar në politikat që prekin jetën e tyre.

b) Rritja e Përfshirjes së të Rinjve me Nevoja të Veçanta

Projektligji përfshin rregullime për krijimin përmes politikave rinore, të kushteve shoqërore, financiare dhe fizike për pjesëmarrjen në jetën publike, sociale, ekonomike dhe kulturore të rinjve, që i përkasin grupeve të marginalizuara, me nevoja të veçanta, me akses të kufizuar në shërbime dhe burime dhe të rinjve rinj jo në punësim, arsim ose formim profesional.

c) Krijimi i Programeve Kombëtare për Mbështetjen e të Rinjve

Projektligji parashikon ngritjen e disa programeve kombëtare, si Programi Kombëtar i Praktikave të Punës, Programi i Talenteve Rinore dhe projektet me impakt komunitar. Këto programe synojnë të ndihmojnë të rinjtë të fitojnë përvojë profesionale, të zhvillojnë talentet e tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të mbështesin aktivizimin e tyre në përmirësimin e jetës në komunitet. Përfitimet sociale të këtyre programeve përfshijnë zhvillimin e aftësive personale dhe profesionale të të rinjve, rritjen e mundësive të punësimit dhe ndërtimit e një kulture të pjesëmarrjes aktive në shoqëri.

d) Ngritja e Qendrave Rinore

Një nga objektivat kryesore të projektligjit është krijimi i qendrave rinore në të gjitha bashkitë e vendit. Këto qendra do të ofrojnë shërbime sociale, kulturore dhe edukative për të rinjtë, duke krijuar hapësira të sigurta për zhvillimin e aktiviteteve komunitare dhe për rritjen e ndërgjegjësimit mbi çështjet sociale.

Ndikimet Sociale të Jo të Drejtpërdrejta:

Projektligji pritet të ketë edhe ndikime sociale jo të drejtpërdrejta, të cilat lidhen kryesisht me përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve dhe të komuniteteve ku ata jetojnë.

a) Rritja e Ndërgjegjësimit mbi Çështjet Sociale dhe Mjedisore

Projektligji parashikon mbështetjen e projekteve me impakt komunitar, të cilat do të realizohen nga grupet rinore dhe këshillat rinore vendorë. Këto projekte do të ndikojnë në rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve për çështje të rëndësishme sociale, si barazia gjinore, të drejtat e njeriut, mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

b) Forcimi i Solidaritetit dhe Përfshirjes Sociale

Projektligji synon të forcojë solidaritetin dhe përfshirjen sociale në komunitete përmes aktiviteteve rinore që promovojnë bashkëpunimin dhe dialogun ndërmjet të rinjve, duke u fokusuar në mënyrë të posaçme tek të rinjtë nga grupet e marginalizuara dhe me nevoja të veçanta. Kjo do të ndihmojë në zvogëlimin e diskriminimit dhe në krijimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Financimi	2025	2026	2027
Total	50,000,000	50,000,000	50,000,000
Buxheti i shtetit	50,000,000	50,000,000	50,000,000
Të pambuluara	-	-	-

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Nëpërmjet Urdhrit nr.13, datë 13.11.2023, të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është ngritur Grupit Ndërinstitucional i Punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 "Për Rininë" me anëtarë nga kabineti i Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare të Rinisë.

Procesi i konsultimeve për ndryshime në Ligjin 75/2019 “Për Rininë” ka filluar gjatë periudhës Janar-Nëntor 2024 dhe ka përfshirë turin e konsultimit të zhvilluar nga Grupi Ndërinstitucional i Punës me aktorët e jashtëm, si organizata të shoqërisë civile, rrjete dhe organizata rinore, të rinj përmes takimeve të posaçme fizike, takimeve online dhe emailit.

Projektligji për “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike dhe ka zgjatur në datat 27.11.2024-25.12.2024.

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/801>

Metodat e konsultimit të përdorura për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, përfshijnë:

- Konsultime fizike dhe online me aktorët e synuar dhe grupet e interesit për ndërmarrjen e vlerësimit ex post të ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, dhe akteve nënligjore dhe përgatitjes së propozimeve ligjore bazuar në vlerësimin e nevojave, synimeve, prioriteteve dhe propozimeve të aktorëve shoqëror ku përfshihen:
- Gjatë muajit qershor 2024 u zhvillua një workshop-i për rishikimin e ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”. Gjatë këtij aktiviteti u angazhuan mbi 80 përfaqësues nga institucionet shtetërore qendrore dhe vendore, përfaqësuesve të organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC), rinore dhe për të rinjtë, këshillit kombëtar të rinisë, këshillave vendore rinore, të organizatave rinore ombrellë, këshillave studentorë, të organizatave donatore/partnerëve për zhvillim në sektorin e rinisë dhe ekspertëve dhe studiuesve në fushën e rinisë që u angazhuan në diskutimin e hapur dhe të strukturuar lidhur me arritjet, problematikat dhe nevojat për rishikimin e Ligjit për Rininë. Për marrjen e kontributeve në mënyrë efektive, workshop-i u konceptua në formën e katër tryezave të veçanta të punës që trajtuan aspektet e ligjit të grupuara sipas katër temave:
 - Kompetencat, funksionet dhe angazhimi i institucioneve shtetërore në fushën e rinisë.
 - Organizimi dhe veprimtaria e strukturave dhe organizatave me të rinjtë.
 - Financimet për rininë
 - Krijimi i kushteve për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve.
- Gjatë muajit korrik 2024 u zhvillua turi i konsultimeve me të rinjtë “**Rinia ndryshon ligjet**”, në 11 bashki të vendit, përkatësisht Kurbin, Shkodër, Lushnje, Kuçovë, Dibër, Durrës, Librazhd, Tiranë, Tropojë, Konispol. Me qëllim lehtësimin e marrjes së kontributeve nga të rinjtë u përgatitën materialet informuese dhe pyetësorët për të dy ligjet në version elektronik, të cilat ju prezantuan atyre përmes platformës Kahoot.
- Takime konsultuese fizike dhe online me përfaqësuesit e 48 organizatave jofitimprurëse rinore dhe/ose për të rinjtë.
- Zhvillimi i Bootcampit më datë 29-31 Korrik 2024, gjatë të cilit anëtarët e KVR-ve diskutuan lidhur me propozimet e tyre për Ligjin për Rininë.
- Grupi i Punës është mbledhur tre herë gjatë periudhës së tretë të raportimit dhe puna ka qenë e fokusuar kryesisht në zbardhjen dhe përpunimin të dhënave dhe rekomandimeve pas zhvillimit turit të konsultimeve me të rinjtë, ëorkshopit me organizatave të shoqërisë civile dhe rekomandimet e përcjella pranë MSHRF nga aktorë të ndryshëm shoqëror gjatë kësaj periudhe.
- Konsultime përmes emailit, ku aktorët e shoqërisë civile patën mundësinë të dërgonin propozimet e tyre tek anëtarët e grupit të punës.
- Konsultime përmes REJNK, në datat 27.11.2024-25.12.2024.

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/801>

Palët e interesuara të cilat kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, përfshijnë:

- 48 organizata të shoqërisë civile rinore/për të rinj që morën pjesë në konsultimet fizike/online ose kanë përcjellë rekomandimet e tyre përmes postës elektronike dhe regjistrat elektronik;
- 480 të rinj, anëtarë të KVR-ve, KKR-së, studentë dhe punonjës rinore që dhënë rekomandimeve përmes turit të konsultimeve me të rinjtë dhe takimeve të tjera.
- Ekspertë kombëtar dhe ndërkombëtar të mbështetur nga projekte të UNICEF dhe UNOPS.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi i masave ligjore do të bazohet mbi një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese, që kombinon burimet dhe mekanizmat në dispozicion të institucioneve shtetërore përgjegjëse me ato të organizatave përfaqësuese dhe strukturave të të rinjve.

a) Institucionet Përgjegjëse për Zbatimin

- Agjencia Kombëtare e Rinisë, që do të luajë një rol kyç në zbatimin dhe koordinimin e masave të parashikuara në këtë ligj.
- Bashkia, do të ketë një rol të rëndësishëm në zbatimin dhe mbështetjen e masave të ligjit në nivel vendor.

b) Mekanizmat e Monitorimit

- Ministria përgjegjëse për rininë do të hartojë metodologjinë dhe ndërmarrë mbi baza vjetore monitorimin e zbatueshmërisë të ligjit.
- Monitorimi i zbatueshmërisë së ligjit do të të përfshijë përgatitjen e metodologjisë dhe treguesve për matjen e nivelit të zbatimit të ligjit dhe akteve nën ligjore, ndikimit të prodhuar prej tij, shkallën e realizimit të objektivave të ligjit në cilësi, sasi dhe kohë, matjen e njohjes dhe përdorimit të ligjit nga aktorët dhe përfituesit etj.
- Monitorimi do të përfshijë grumbullimin e të dhënave parësore nga vetë Ministria, AKR-ja dhe bashkitë dhe të dhënave dytësore, nga vëzhgimet dhe raportimet e institucioneve shtetërore, organizatave rinore/për të rinjtë.

c) Transparenca dhe Përfshirja e Grupeve të Interesit

- Do të bashkëpunohet dhe do të shkëmbehet informacioni në mënyrë të vazhdueshme me grupet e interesit gjatë procesit të monitorit të zbatimit të ligjit dhe raportet e monitorimit të zbatimit të ligjit do të publikohen në faqet zyrtare të Ministrisë dhe AKR-së.
- Do të synohet përfshirja e organizatave rinore/për të rinjtë dhe grupet e interesit në procesin dhe aktivitetet e monitorimit të ligjit për të siguruar një vlerësim real të zbatueshmërisë dhe ndikimit të ligjit në praktikë.

d) Masat për Përmirësimin e Zbatimit

- Ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuere për të promovuar ligjin dhe masat e parashikuara prej tij.
- Trajnimi i punonjësve rinorë dhe i stafit të bashkive për zbatimin e ligjit.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Ligji nr. 75 “Për Rininë” u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2019. Ligji përcakton aktivitetet, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Shqipëri dhe synon rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e politikëbërëse dhe vendimmarrjes në nivel qendror dhe vendor. Ligji prezantoi koncepte të reja dhe ofroi rregullime për çështjet dhe strukturat që lidheshin me rininë: si edukim joformal për të rinjtë, dialogu i strukturuar mes të rinjve, grupmosha rinore, hapësira e sigurt rinore, organizata rinore, organizata për të rinj etj. Ligji po ashtu, parashikon sigurimin e burimeve të financimit për politikën, programet dhe aktivitetet rinore, duke theksuar kontributin e buxheteve vendore në këtë drejtim, krahas buxhetit të shtetit.

Bazuar mbi përcaktimet e Ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”, u miratuan aktet nën ligjore për ngritjen e institucioneve përgjegjëse dhe strukturave konsultative për rininë, si vijon:

- Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, bazuar në vendimin nr. 524 dt 22.09.2021 të Këshillit të Ministrave “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët”, harton dhe zbaton politika që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve dhe garantimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën sociale dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, përkujdesjen, shëndetin, mirërritjen dhe mirëedukimin e fëmijëve.
- Agjencia Kombëtare për Rininë (AKR) është ngritur përmes me vendimit Nr. 681, datë 2.09.2020 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë” duke zëvendësuar Shërbimin Kombëtar Rinor (SHKR). AKR ka mision të garantojë dhe promovojë të drejtat e të rinjve nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimet e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në bazë dhe për zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë
- Këshilli Kombëtar i Rinisë, si organ këshillimor me të rinj, i ngritur pranë Ministrisë të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, bazuar në vendimin Nr. 969, datë 2.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë dhe organizimin dhe funksionimin e tij”.
- Këshilli Vendor i Rinisë si organ këshillimor me të rinj, i ngritur pranë kryetarit të bashkisë, bazuar në kriteret dhe procedurat e miratuara nga Këshilli Bashkiak i çdo bashkie.
- Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore (OKPR), bazuar në vendimin nr.274, datë 12.05.2021 të Këshillit të Ministrave, krijuar si organizatë jo fitimprurëse për përfaqësimin e të rinjve, me anëtarësi nga organizatat rinore/për të rinjtë dhe shtrirje në të gjitha qarqet e vendit.

Po ashtu është plotësuar kuadri rregullator, strategjik dhe i politikave për rininë, që i shërben realizimit të objektivave të ligjit përmes:

- Miratimit të Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022–2029 dhe planit të saj veprimit, përmes vendimit Nr.692, datë 26.10.2022 të Këshillit të Ministrave. Strategjia përbën dokumentin bazë për përgatitjen e politikave që synojnë aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve në Shqipëri dhe adresimin e problemeve me të cilat ata përballen, që lidhen me sfida si përfshirja në proceset vendimmarrëse, punësimi dhe edukimi, mungesa e mundësitë të vlefshme në tregun e punës, si problematikat e lidhura me mirëqenien aktive, të shëndetshme, sociale, fizike, kulturore dhe emocionale të të rinjve.
- Miratimit të vendimit nr. 566 datë 29.07.2022, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë”, që i hapi rrugë financimit të projekteve të përgatitura nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, me fokus mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të të rinjve, si dhe projekt-propozimeve të përgatitura nga bashkitë për ndërtimin/rikonstruksionin e objekteve publike të infrastrukturës vendore.

Megjithëse realizimi i objektivave dhe zbatueshmëria e Ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë” është vlerësuar në nivele të kënaqshme, gjatë zbatimit pesëvjeçar të tij, janë evidentuar edhe mangësi dhe paqartësi, në rregullimet e tij.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave*

Problemi kryesor që synon të adresojë projektligji lidhet me mangësitë e kuadrit ligjor ekzistues për rininë, i cili në kushtet aktuale, nuk garanton në mënyrë të plotë përfaqësimin, mbështetjen dhe mbrojtjen e të drejtave të të rinjve. Kuadri ligjor ekzistues ka mangësi lidhur me rregullimet që nevojiten për mbështetjen dhe aktivizimin e të rinjve me nevoja të veçanta dhe në kushte privimi, për sigurimin e pjesëmarrjes efektive së të rinjve në vendimmarrje si dhe për unifikimin dhe sigurimin e standardeve të cilësisë për shërbimet rinore.

Disa nga shkaqet kryesore të lidhura me problemin përfshijnë, si vijon:

- Kuadri ligjor ofron rregullime të pamjaftueshme dhe përkufizime të paqarta ligjore:
 - Ligji aktual ofron përkufizime të paqarta mbi organizatën rinore dhe përgjegjësitë e njësive të vetë qeverisjes vendore për mbrojtjen dhe mbështetjen e të rinjve.

- Ligji aktual nuk ofron rregullime të përshtatshme për mbështetjen e organizmin dhe aktivizimin e të rinjve, veçanërisht në bashkitë e vogla dhe zonat rurale, ku evidentohet mungesa e pranisë së organizatave rinore dhe për të rinj.
- Ligji aktual nuk ofron përcaktime mbi punonjësin rinor si dhe për kompetencat dhe kualifikimet që duhet të zotërojë personi që kryen punën rinore.

- Mundësimi i shërbimeve rinore është i cunguar dhe i paqëndrueshëm:

- Qendrat rinore mungojnë në shumë bashki dhe aty ku funksionojnë, dëshmojnë burime të kufizuara njerëzore dhe logjistike për të mundësuar shërbime rinore dhe punën rinore cilësore.
- Evidentohet bashkëveprim i ulët dhe sporadik midis bashkive dhe organizatave rinore/për të rinjtë në përdorimin e infrastrukturës rinore në potencialin e plotë të saj.
- Mungon kuadri i plotë dhe efektiv për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të qendrave rinore dhe nuk ka standarde bazë për sigurimin e cilësisë dhe mirëfunksionimin e tyre në mbarë vendin.

- Politikat dhe veprimtaritë rinore nuk janë gjithëpërfshirëse:

- Evidentohet nivel i ulët i përfshirjes dhe përfitimit nga politikat dhe veprimtaritë rinore i të rinjve që i përkasin grupeve të marginalizuara, përfshirë atyre nga zonat rurale, komunitetet rom dhe egjiptian, të rinjve me aftësi të kufizuara dhe të rinjve JPAFP.

Problemi është i evidentuar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe prek në mënyrë të veçantë të rinjtë e grupmoshës 15-29 vjeç, që grupeve të marginalizuara, përfshirë atyre nga zonat rurale, komuniteti rom dhe egjiptian, të rinjve me aftësi të kufizuara dhe të rinjve JPAFP. Mungesa e qendrave rinore funksionale, shërbimet rinore pa standarde, vështirësitë dhe burokracitë në organizimin e të rinjve e bëjnë problemin të prekshëm në të gjitha nivelet: vendor, rajonal dhe kombëtar. Problemi prek gjithashtu edhe institucionet publike, të cilat kanë përgjegjësi për zbatimin e politikave rinore në mënyrë efektive dhe mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të çdo të riu, pavarësisht kushteve sociale, ekonomike dhe fizike të tij.

Grupet e Prekura nga Problemi:

- Të rinjtë: Janë grupi më i prekur nga problemi, veçanërisht ata që i përkasin grupeve të marginalizuara (të rinjtë me aftësi të kufizuara, të rinjtë nga komuniteti rom dhe egjiptian, të rinjtë nga zonat rurale, të rinjtë JPAFP etj.).
- Qeveria dhe pushteti vendor: Institucionet publike që kanë përgjegjësi për zbatimin e ligjit dhe ofrimin e mbështetjes dhe shërbimeve për të rinjtë.
- Shoqëria civile: Organizatat përfaqësuese dhe ato që punojnë për mbrojtjen dhe mbështetjen e të rinjve.
- Bizneset: Në mënyrë indirekte, bizneset preken nga ky problem pasi mungesa e aftësive dhe përvojave praktike të të rinjve ndikon negativisht në tregun e punës.

Mundësia për të Trajtuar Problemin përmes Ndryshimit të Politikave:

Problemi mund të trajtohet në mënyrë efektive përmes zbatimit të politikave të reja që adresojnë nevojat e të rinjve. Ndryshimet e propozuara në projektligjin për rininë përfshijnë:

- Përmirësimin e mekanizmave të përfaqësimit të të rinjve në strukturat vendimmarrëse.
- Krijimin e qendrave rinore me standarde të larta dhe unifikuara në të gjithë territorin.
- Mbështetjen e programeve për zhvillimin e aftësive dhe prirjeve të të rinjve dhe përmirësimin e mundësive për punësim dhe integrimin social të tyre.
- Forcimin e rolit të bashkive në ofrimin e shërbimeve për të rinjtë dhe monitorimin e zbatimit të ligjit.

Zbatimi i këtyre ndryshimeve do të krijojë një kuadër efektiv institucional dhe rregullator në fushën e rinisë, duke siguruar mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë*

Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe për të garantuar që të rinjtë në Shqipëri të kenë mundësi të barabarta për pjesëmarrje, zhvillim dhe përfitim nga politikat publike. Aktualisht, kuadri ekzistues ligjor nuk ofron mjaftueshëm mbrojtje dhe mbështetje për të rinjtë, veçanërisht tyre që i përkasin grupeve më në nevojë.

Qeveria synon të trajtojë disa çështje kryesore përmes ndryshimeve në ligjin për rininë:

- Rritjen e përfaqësimit dhe angazhimit efektiv të të rinjve në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse.
- Mbështetjen e të rinjve që i përkasin grupeve të marginalizuara, përfshirë atyre nga zonat rurale, komunitetet rom dhe egjiptian, të rinjve me aftësi të kufizuara dhe të rinjve JPAFP, përmes politikave rinore të dedikuara dhe përshtatjes së politikave ekzistuese.
- Ngritjen e programeve të reja që zgjerojnë mundësitë për zhvillim personal dhe profesional të të rinjve.
- Standardizimin dhe përmirësimin e shërbimeve rinore në të gjithë vendin.

Ndërhyrja e qeverisë duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të përfshijë disa nivele:

- Në nivel legjislativ: Miratimi i ndryshimeve në ligjin për rininë dhe i akteve nën ligjore të tij, për të adresuar mangësitë e identifikuara.
- Në nivel qendror: Krijimi i mekanizmave të reja dhe forcimi i strukturave ekzistuese për zbatimin e ligjit.
- Në nivel vendor: Rritja e përfshirjes së bashkisë në ofrimin e shërbimeve rinore dhe monitorimin e zbatimit të politikave rinore në nivel vendor.

Kjo nismë është në përputhje me objektivat strategjike të qeverisë shqiptare për rininë, të cilët përfshijnë:

- Promovimin e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në jetën publike.

- Rritjen e përfshirjes në arsim, punësim, formim dhe shërbime sociale për të rinjtë.
- Mbështetjen e të rinjve nga grupet e të marginalizuara dhe sigurimin e përfshirjes dhe kohezionit social.
- Përmirësimin e infrastrukturës dhe mekanizmave sociale dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillimin e talenteve dhe aftësive të të rinjve.

Deri më tani, disa hapa janë ndërmarrë në kuadër të zhvillimit të politikave rinore:

- Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, që përcakton qëllimet, objektivat, dhe masat për mbështetjen e të rinjve sipas indikatorëve të matshëm për periudhën 2022-2029 .
- Ngritja dhe fuqizimi i Agjencisë Kombëtare të Rinisë, e cila ka për detyrë të koordinojë zbatimin e politikave rinore.
- Mbështetja dhe financimi i veprimtarisë të organizatave rinore dhe për të rinjtë me anë të fondit grant të dedikuar për rininë, si dhe ndryshimit të metodologjisë së grantdhënies me qëllim përafrimin me metodologjitë e Bashkimit Evropian, është përdorur metodologjia LOD, që ofron transparencë dhe rrit efikasitetin.
- Ndërtimi/rikonstruksioni i 15 objekteve publike të infrastrukturës rinore në bashki të ndryshme të vendit, që i shërbejnë të rinjve të vendit.
- Organizimi i konsultimeve publike me të rinjtë dhe organizatat rinore, për të marrë mendime dhe rekomandime mbi përmirësimin e ligjit.

Me gjithë rezultatet e arritura, puna e kryer nuk ka qenë e mjaftueshme për të adresuar të gjitha sfidat dhe për të siguruar mbrojtjen dhe mbështetjen gjithëpërfshirëse për të rinjtë në të gjithë vendin. Ndërhyrja e propozuar përmes këtij projektligji synon të plotësojë këto mangësi dhe të krijojë një kuadër më efektiv dhe të qëndrueshëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Shqipëri.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë*

Objektivat kryesorë të politikës janë:

- Të rinjtë marrin pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike të vendit, përmes forcimit të mekanizmave konsultative në nivel qendror dhe vendor. brenda vitit 2029.
- Krijohen dhe rinovohen 25 qendra rinore të projektuara për të rinjtë, me qëllim përmirësimin e qasjes së të rinjve në hapësira të sigurta takimi edhe në kohën e lirë, brenda vitit 2027.
- Politikat dhe veprimtaritë rinore përshtaten me qëllim përfshirjen e të rinjve nga grupe të marginalizuara.
- Të rinjtë mbështeten me programe vjetore për trajnimin dhe praktika pune për të rritur mundësitë e integritit të tyre në tregun e punës.
- Ofrohen mundësi të posaçme dhe vjetore për mbështetjen e të rinjve të talentuar si dhe programe për nisma komunitare që krijojnë mundësi angazhimi për të rinjtë në bashkitë ku ata jetojnë, për tu bërë faktorë të ndryshimit.

- Standardizohen dhe përmirësohen shërbimet rinore në nivel lokal dhe kombëtar. Gjithashtu në referim të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, në Qëllimin Politik 1, i cili është i lidhur me fuqizimin e të rinjve, dy nga Objektivat Specifikë të SKR, kanë parashikuar, konkretisht:

- **Objektivi Specifik 1.2:** Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.
- **Objektivi Specifik 2.3** “Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore” dhe masa konkrete: *“Sigurohet mbështetje e përshtatshme dhe miqësore për të rinjtë dhe të rejtat e në veçanti për ata me aftësi të kufizuara mbi punësueshmërinë e tyre, punësimin dhe sipërmarrjen rinore”*

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura*

Janë shqyrtuar tre opsione kryesore për ndryshimin e kuadrit ligjor për rininë, si më poshtë:

Opsioni 0: Status Quo (Pa Ndryshime)

Opsioni i ruajtjes së status quo-së përfshin mbajtjen e situatës aktuale pa ndërhyrje ligjore apo institucionale për të adresuar çështjet e identifikuar në lidhje me organizatat rinore dhe mbrojtjen e të drejtave të të rinjve.

Avantazhet:

- **Kosto të ulëta financiare dhe administrative:** Ruajtja e status quo-së nuk kërkon alokimin e burimeve shtesë financiare apo njerëzore nga institucionet publike. Proceset ekzistuese mbeten të pandryshuara, duke shmangur shpenzimet për trajnime, konsultime publike, apo reforma strukturore.
- **Stabilitet institucional:** Mungesa e ndërhyrjeve ruan sistemin aktual, duke shmangur pasigurinë dhe potencialet për sfida në zbatimin e ndryshimeve të reja.

Disavantazhet:

- **Problemet ekzistuese mbeten të pazgjidhura:**
 - **Përkufizime të paqarta për organizatat rinore:** Kufijtë dhe kriteret për organizatat rinore vazhdojnë të jenë të paqarta, duke krijuar paqartësi për regjistrimin, njohjen dhe mbështetjen e këtyre organizatave.
 - **Mekanizma të pamjaftueshëm për mbrojtjen e të drejtave të të rinjve:** Nuk krijohen apo përmirësohen strukturat për të monitoruar dhe garantuar mbrojtjen

e të drejtave të të rinjve, duke i lënë ata të ekspozuar ndaj sfidave dhe diskriminimit të mundshëm.

- **Rreziku i përkeqësimit të situatës:** Pa reforma, mund të ndodhë përkeqësim i mëtejshëm i funksionimit të organizatave rinore dhe të sistemit të mbrojtjes së të drejtave të të rinjve.
- **Mungesa e përmirësimit në adresimin e nevojave të të rinjve:** Situata aktuale nuk pasqyron mjaftueshëm nevojat dhe prioritetet e të rinjve, duke kufizuar potencialin e tyre për pjesëmarrje aktive dhe zhvillim social-ekonomik.

Ruajtja e status quo-së mund të shihet si një zgjidhje e thjeshtë dhe pa kosto të menjëhershme, por ajo nuk garanton adresimin e sfidave ekzistuese dhe as nuk i përgjigjet nevojave në zhvillim të të rinjve dhe organizatave që i përfaqësojnë ata.

Opsioni 1: Shfuqizimi i Ligjit Aktual dhe Miratimi i Një Ligji të Ri

Ky opsion parashikon shfuqizimin e ligjit ekzistues dhe krijimin e një kuadri tërësisht të ri ligjor për rininë, duke ndërtuar një bazë të re rregullatore për të adresuar nevojat dhe sfidat e të rinjve.

Avantazhet:

- **Risi potenciale në konceptim:** Megjithëse në analizën aktuale nuk janë evidentuar avantazhe të dukshme, ky opsion mund të ofrojë mundësi për të rishikuar rrënjësisht politikat për rininë dhe për të ndërtuar një qasje të re që adreson më mirë nevojat e tyre.

Disavantazhet:

- **Kosto të larta financiare dhe njerëzore:** Hartimi dhe zbatimi i një ligji të ri kërkon angazhimin e burimeve të mëdha financiare dhe njerëzore, përfshirë ekspertë, konsultime publike dhe procese administrative komplekse.
- **Pasiguri ligjore:** Gjatë periudhës tranzitore, deri në zbatimin e plotë të ligjit të ri, mund të krijohen boshllëqe ligjore dhe paqartësi që ndikojnë negativisht te të rinjtë dhe organizatat rinore.
- **Nuk është efikas** për sa kohë ndryshimet e propozuara nuk prekin më shumë se 50% të përmbajtjes së ligjit aktual.
- **Kohëzgjatje e madhe për zbatim:** Procesi i miratimit dhe zbatimit të një ligji të ri mund të zgjasë shumë, duke lënë të pazgjidhura problemet aktuale për një periudhë të gjatë kohore.
- **Rreziku i rezultateve të paparashikuara:** Krijimi i një kuadri të ri nga fillimi mund të sjellë sfida të reja apo probleme të papritura që nuk janë evidentuar gjatë hartimit.

Ky opsion përfshin një qasje radikale dhe komplekse që nuk garanton përmirësim të menjëhershëm apo efektiv në adresimin e çështjeve ekzistuese. Për më tepër, kostot dhe pasiguritë e lidhura me këtë qasje e bëjnë atë më pak të preferuar, përveçse në rastet kur ndryshimi rrënjësor është absolutisht i nevojshëm dhe i justifikueshëm.

Opsioni 2 (i preferuar): Ndryshimi i ligjit aktual, pra i ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”.

- **Avantazhet:**
 - Përmirëson kuadrin ligjor ekzistues pa e shfuqizuar atë, duke ruajtur stabilitetin e rregullimeve të tanishme.

- Adreson të gjitha problematikat e evidentuara në ligjin aktual në mënyrë efektive dhe të plotë.
- Lejon zbatimin në mënyrë të shpejtë dhe të përshtatshme të politikave të reja në mbështetje të rinisë.
- Harmonizohet me praktikën dhe standardet ndërkombëtare, veçanërisht ato të BE-së.
- **Disavantazhet:**
 - Krijon kosto shtesë financiare për institucionet publike krahasuar me opsionin 0.
 - Kërkon burime të reja për ndryshime të kuadrit rregullator dhe administrativ krahasuar me opsionin 0.

Opsioni 3: Ndërhyrja nëpërmjet masave jorregullatore

- Organizimi i fushatave ndërgjegjëse për rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje.
- Edukimi nëpërmjet organizimit të trajnimeve për të rinjtë mbi të drejtat e tyre, mundësitë për përfshirje sociale dhe politike, si dhe përfitimet nga angazhimi në organizata rinore.
- Nxitja e bashkëpunimit midis qeverisë, shoqërisë civile dhe sektorit privat për projekte rinore.
- Forcimi i strukturës ekzistuese duke kryer investime për përmirësimin e qendrave rinore ekzistuese dhe për hapjen e qendrave të reja.
- Nxitja e pjesëmarrjes në nivel vendor.
- Etj

Ky opsion paraqet disa avantazhe në krahasim me opsionet e tjera, ndër të cilat koha më e shkurtër për ta zbatuar. Megjithatë disavantazhi kryesor është pamundësia e zgjidhjes së problemeve që kërkojnë ndërhyrje rregullatore për t'u trajtuar në mënyrë të përshtatshme. Për këtë arsye nuk mundëson arritjen e të gjitha objektivave të vendosura dhe nuk mund të zgjidhet si opsion i preferuar.

Pas analizës së avantazheve dhe disavantazheve të çdo opsioni, është vlerësuar se opsioni i ndryshimit të ligjit aktual (Opsioni 2) është më i përshtatshmi. Ky opsion siguron përmirësimin e kuadrit ligjor në mënyrë efektive dhe garanton mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Shqipëri.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*

- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Ndryshimet në projektligjin për rininë do të kenë ndikime mbi disa grupe të ndryshme, duke përfshirë:

- Të rinjtë (grupmosha 15-29 vjeç).
- Institucionet publike (pushteti qendror dhe vendor).
- Organizatat rinore dhe për të rinjtë.

Ndikimet e drejtpërdrejta përfshijnë:

- Të rinjtë: Pjesëmarrje më aktive në vendimmarrjen qendrore dhe vendore, në fushën e rinisë, rritja e aksesit në shërbime rinore, zhvillimi i aftësive profesionale dhe talenteve të të rinjve, rritja e përfshirjes së tyre në tregun e punës, përfitimi i shërbimeve rinore më cilësore dhe në të gjithë territorin e vendit.
- Institucionet publike: rritja e efektivitetit të politikave shtetërore rinore, përmirësimi i mekanizmave të monitorimit dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për zbatimin e politikave rinore, përfshirja dhe kontributi i të rinjve në punën e institucioneve të administratës shtetërore.
- Organizatat rinore/për të rinj: Mbështetje financiare dhe institucionale më efektive për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, rritja e veprimtarisë së organizatave rinore/për të rinjtë në territor, përmes bashkëpunimit me bashkitë për krijimin dhe operimin e qendrave rinore të përbashkëta.

Analiza Cilësore e Ndikimeve të Drejtpërdrejta:

- Për të rinjtë:

- Sigurimi i mbikëqyrjes, trajnimit, trajtimit ushqimor dhe punësimit së rinjve pjesëmarrës në programin kombëtar të praktikave të punës në institucionet e administratës publike.
- Ngritja e programit të talenteve rinore për mbështetjen e të rinjve në fushat e artit, kulturës, edukimit, shkencës, teknologjisë dhe sportit.
- Njohja dhe mbështetja e grupeve joformale të të rinjve, si një formë më e thjeshtuar dhe me më pak kufizime e organizimit rinor, që do të nxisë më tej organizmin dhe aktivizimin e të rinjve në adresimin e problemeve komunitare, veçanërisht në bashkitë e vogla dhe zonat rurale, ku evidentohet mungesa e pranisë së organizatave rinore dhe për të rinj.
- Harmonizimi dhe racionalizimi i përbërjes së KKR-së, KVR-ve bazuar në kritere objektive dhe të unifikuara në shkallë vendi.
- Rritja e përfaqësimit për të rinjtë brenda KKR-së, KVR-ve në dy të tretat e numrit të anëtarëve. Vendosja e “bashkëkryesimit” të KKR-së, KVR-ve, nga zyrtari më i lartë shtetëror qendror dhe vendor në fushën e rinisë dhe përfaqësuesi i zgjedhur mes të rinjve në këto forume.
- Rritja e funksionalitetit dhe efektivitetit të veprimtarisë së KKR-së dhe KVR-ve, përmes financimit të veprimtarisë së tyre.
- Për institucionet publike:
 - Përmirësimi i kapaciteteve për zbatimin e politikave rinore.
 - Rritja e efektivitetit në ofrimin e shërbimeve për të rinjtë.
 - Ngritja e një komisioni të specializuar për vlerësimin e propozimeve që do mbështeten përmes fondit grant për rininë, duke siguruar efektivitet të lartë në shpërndarjen fondeve dhe rritur sinergjinë mes ndërhyrjeve të aktoreve të ndryshëm rinor që mbështeten prej tij
 - Vendosja e standardeve bazë për strukturimin, rolin, funksionet, sigurinë dhe ofrimin e shërbimeve të qendrave rinore.
- Për organizatat rinore/për të rinjtë:
 - Financimi i projekteve rinore dhe ofrimi i mbështetjes për aktivitetet e tyre.
 - Rritja e veprimtarisë së organizatave rinore/për të rinjtë në territor përmes bashkëpunimit me bashkitë për krijimin dhe operimin e qendrave rinore të përbashkëta.

Analiza Sasiore dhe Vlera Monetare e Ndikimeve të Drejtpërdrejta:

Nëse ndryshimet e propozuara në ligj zbatohen në mënyrë të plotë:

Për të rinjtë parashikohen përfitime monetare nga Programi i Talenteve Rinore dhe për kompensimin e shpenzimeve në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, KVR-së, KKR-së, gjithashtu edhe mbështetje për grupet joformale, të rinjtë e KVR-së, KKR-së, organizatat rinore për të rinjtë/rinjtë, më konkretisht:

- Një përfitim i drejtpërdrejtë lidhet me mbështetjen buxhetore prej 25 milionë lekësh për praktikantët pjesëmarrës në programin kombëtar të praktikave të punës. Kjo mbështetje buxhetore u ofron mundësi praktikantëve të kenë një praktikë pune të paguar në formën e kompensimit të ushqimeve dhe mundësi trajnimi konkrete. Kjo kosto është e shpërndarë qoftë në formën e kompensimit të shpenzimeve për ushqim për praktikantët e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës për një periudhë 3 muajore, po ashtu edhe pagesa të ASPA për ofrimin e shërbimeve të trajnimit për këta të rinj në mënyrë që të

kenë mundësi të krijojnë një përvojë të plotë duke i bërë më të përgatitur për punësim në sektorin publik ose privat.

- Një ndikim tjetër i drejtpërdrejtë në masën prej 25 milionë lekësh, i referohet dy programeve të reja për të rinjtë, konkretisht: programi i mbështetjes së talentëve dhe programi i mbështetjes së nismave komunitare. Është parashikuar që të talentuar në fusha të ndryshme të shkencës, artit, kulturës, sportit me qëllim pjesëmarrjen në kompeticione ndërkombëtare dhe shpërblimi për rezultatet e arritura, tu ofrohet mbështetja financiare e nevojshme për transport, akomodim etj, në mënyrë që të kenë mundësi të përfaqësimit të vendit dhe pjesëmarrjes në këto nisma si bashkëmoshatarët e tyre të vendeve të tjera. Gjithashtu një fokus i ri do ti jepet nismave me impakt komunitar nga grupet joformale të të rinjve dhe këshillat vendore rinore, ku të rinj të zonave të ndryshme urbane e rurale, mund të marrin mbështetje financiare për idetë e tyre në funksion të përmirësimit të komuniteteve ku ata banojnë.
- Për institucionet publike:
 - Kostoja për ngritjen e qendrave rinore dhe zbatimin e programeve të rinisë. Aktualisht Agjencia Kombëtare e Rinisë, në sajë të Thirrjeve Publike drejtuar Njësive të Vetëqeverisjes vendore për projektpropozime për financim të hapsirave rinore, qendrave rinore, bibliotekave etj, shperndan fonde në masën 50 milionë lekë në vit për 5-6 bashki të mbështetura më një vlerë afërsisht 10 milionë lekë për çdo objekt të infrastrukturës rinore. Qendrat rinore, hapsirat rinore apo bibliotekat e ngritura kanë qenë rezultat i kontributit të mbështetjes buxhetore nga Agjencia Kombëtare e Rinisë në kombinim me bashkëfinancimin e bashkive në minimalisht 10% të vlerës së projektpropozimit.

Ndikimet Jo të Drejtpërdrejta:

- Për të rinjtë: Përmirësimi i kushteve sociale dhe krijimi i një kulture të pjesëmarrjes aktive në jetën publike.
- Për institucionet publike: Përmirësimi i vlerësimit qytetar ndaj institucioneve shtetërore nisur nga mundësimi i shërbimeve cilësore për të rinjtë.
- Për bizneset: Rritja e konkurrueshmërisë përmes punësimit të të rinjve të kualifikuar dhe novatore.¹

Ndikimet Sociale të Jo të Drejtpërdrejta:

- Projektligji pritët të ketë edhe ndikime sociale jo të drejtpërdrejta, të cilat lidhen kryesisht me përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve dhe të komuniteteve ku ata jetojnë.
 - a) Rritja e Ndërgjegjësimit mbi Çështjet Sociale dhe Mjedisore
- Projektligji parashikon mbështetjen e projekteve me impakt komunitar, të cilat do të realizohen nga grupet rinore dhe këshillat rinorë vendorë. Këto projekte do të ndikojnë

¹ Lidhur me ndikimet jo të drejtpërdrejta për biznesin, do të bëhet një vlerësim rast pas rasti, duke qenë se ato do të varen nga faktorë të ndryshëm si vendndodhja e biznesit, niveli i kualifikimit i kërkuar për të rinjtë që punësohen, përvoja etj.

në rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve për çështje të rëndësishme sociale, si barazia gjinore, të drejtat e njeriut, mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

b) Forcimi i Solidaritetit dhe Përfshirjes Sociale

- Projektligji synon të forcojë solidaritetin dhe përfshirjen sociale në komunitete përmes aktiviteteve rinore që promovojnë bashkëpunimin dhe dialogun ndërmjet të rinjve, duke u fokusuar në mënyrë të posaçme tek të rinjtë nga grupet e marginalizuara dhe me nevoja të veçanta. Kjo do të ndihmojë në zvogëlimin e diskriminimit dhe në krijimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.

Diskutimi mbi Kufizimet e Analizës:

- Supozimet:
 - Financimi do të sigurohet brenda afatit dhe kërkesave të përshtatshme.
 - Institucionet publike do të kenë kapacitetet e nevojshme për të zbatuar politikatat e reja.
- Rreziqet:
 - Mund të ketë vonesa në hartimin e akteve nën ligjore për zbatimin e politikave të reja.
 - Mungesa e burimeve financiare mund të ndikojë në efektivitetin e masave të propozuara.
- Provat mbështetëse:
 - Provat bazohen në praktikatat ndërkombëtare dhe rekomandimet nga institucionet e BE-së në fushën e rinisë.

Pas një analize të detajuar të ndikimeve të secilit opsion, opsioni i ndryshimit të ligjit aktual (Opsioni 2) është vlerësuar si më i përshtatshmi për të arritur objektivat e politikave. Ky opsion siguron një balancë të mirë mes përfitimeve dhe kostove dhe adreson në mënyrë efektive problematikat ekzistuese në kuadrin ligjor për rininë.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është përzgjedhur opsioni 2 “Ndryshimi i ligjit nr. 75/2019, “Për Rininë”. Ky opsion është vlerësuar si opsioni i preferuar dhe më efektiv, pasi adreson boshllëqet ekzistuese në mënyrë efektive, përmirëson përfaqësimin e të rinjve dhe rrit mbështetjen për të rinjtë, për grupet joformale rinore, bashkitë si dhe organizatat rinore dhe për të rinjtë. Ky opsion siguron stabilitet institucional, shmang pasigurinë ligjore dhe harmonizohet me praktikatat ndërkombëtare.

Ndërhyrja në ndryshimin e këtij ligji do të ndihmojë gjithashtu në harmonizimin e politikave rinore me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë praktikatat më të mira të Bashkimit Evropian në fushën e rinisë. Përmes ndryshimit të ligjit, Shqipëria do të mund të krijojë një kuadër të ligjor efektiv, që garanton mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Për të dhënë një ide më të qartë të arsyeve së përzgjedhjes së Opsionit 2 si opsioni i preferuar për implementimin e politikës, është përgatitur analiza me shumë kritere.

Opsionet që janë marrë në konsideratë për analizën me shumë kritere janë:

Opsioni 0: Ruajtja e status quo-së, të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues.

Opsioni 1: Shfuqizimi i ligjit aktual dhe miratimi i një ligji të ri.

Opsioni 2: Ndryshimi i ligjit nr. 75/2019, “Për Rininë”.

Opsioni 3: Ndërhyrja nëpërmjet masave jo rregullatore.

Për të vlerësuar opsionet duke përdorur analizën me shumë kritere, janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

Janë përcaktuar kriteret që tregojnë arritjen e objektivave:

1. Fuqizimi i të rinjve që të marrin pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike të vendit.
2. Mbështetja e të rinjve me shërbime rinore cilësore në komunitet.
3. Përfshirja dhe përfitimi nga politikat rinore të rinjve me nevoja të veçanta.
4. Hartimi i një kuadri ligjor të kuptueshëm dhe funksional në fushën e rinisë.
5. Kosto – efektiviteti.

Kriteret	Pesha	Opsioni 0		Opsioni 1		Opsioni 2		Opsioni 3	
	(Rëndësi a relative)	Pikë	Vlera	Pikë	Vlera	Pikë	Vlera	Pikë	Vlera
		-	(=Pesh a x pikë)	-	(=Pesh a x pikë)	-	(=Pesh a x pikë)	-	(=Pesh a x pikë)
Fuqizimi i të rinjve që të marrin pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike të vendit	4	0	0	1	4	5	20	1	4
Mbështetja e të rinjve me shërbime rinore cilësore në komunitet	4	0	0	1	4	5	20	1	4

Perfshirja dhe përfitimi nga politikat rinore të rinjve me nevoja të veçanta	<u>4</u>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>2</u>	<u>8</u>	<u>4</u>	16	<u>1</u>	4
Hartimi i një kuadri ligjor të kuptueshëm dhe funksional në fushën e rinisë	<u>4</u>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>2</u>	<u>8</u>	<u>4</u>	16	<u>1</u>	4
Kosto – efektiviteti	<u>4</u>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>1</u>	<u>4</u>	<u>5</u>	20	<u>1</u>	4
<u>Pikët totale për secilin opcion</u>	-	<u>0</u>	-	<u>28</u>	-	<u>92</u>	-	<u>20</u>	

Opsioni 2 (i preferuar) - ndryshimi i ligjit aktual nr. 75/2019 “Për Rininë” pasi adreson boshllëqet ekzistuese në mënyrë efektive, siguron përfaqësimin e të rinjve dhe rrit mbështetjen për të rinjtë, për grupet joformale rinore, bashkitë, si dhe organizatat rinore dhe për të rinjtë. Ky opcion siguron stabilitet institucional, shmang pasigurinë ligjore dhe harmonizohet me praktikën ndërkombëtare. Kostot shtesë janë të justifikueshme duke pasur parasysh përfitimet afatgjata për të rinjtë dhe shoqërinë në tërësi.

Elementët kyç të ligjit të ri:

- Harmonizimi dhe racionalizimi i përbërjes së KKR-së, KVR-ve bazuar në kritere objektive dhe të unifikuara në shkallë vendi.
- Rritja e përfaqësimit për të rinjtë brenda KKR-së, KVR-ve në dy të tretat e numrit të anëtarëve.
- Vendosja e “bashkëkryesimit” të KKR-së, KVR-ve, nga zyrtari më i lartë shtetëror qendror dhe vendor në fushën e rinisë dhe përfaqësuesi i zgjedhur mes të rinjve në këto forume.
- Rritja e funksionalitetit dhe efektivitetit të veprimtarisë së KKR-së dhe KVR-ve, përmes financimit të veprimtarisë së tyre.
- Sigurimi i mbikëqyrjes, trajnimit, trajtimit ushqimor dhe punësimit të rinjve programit kombëtar të praktikave të punës në institucionet e administratës publike.
- Ngritja e programit të talentëve rinore për mbështetjen e të rinjve në fushat e artit, kulturës, edukimit, shkencës, teknologjisë dhe sportit.
- Njohja dhe mbështetja e grupeve joformale të të rinjve, si një formë më e thjeshtuar dhe me më pak kufizime të organizimit rinor, që do të nxisë më tej organizmin dhe

aktivizimin e të rinjve në adresimin e problemeve komunitare, veçanërisht në bashkitë e vogla dhe zonat rurale, ku evidentohet mungesa e pranisë së organizatave rinore dhe për të rinj.

- Ngritja e një komisioni të specializuar për vlerësimin e propozimeve që do mbështeten përmes fondit grant për rininë, duke siguruar efektivitet të lartë në shpërndarjen fondeve dhe rritur sinergjinë mes ndërhyrjeve të aktoreve të ndryshëm rinor që mbështeten prej tij
- Ngritja e qendrave rinore si person juridik, duke forcuar bashkëpunimin mes bashkive dhe organizatave rinore/për të rinjtë me qëllim mirëfunksionimin, rritjes së qëndrueshmërisë financiare të tyre dhe mbështetur ngritjen e tyre në të gjithë bashkitë e vendit.
- Vendosja e standardeve bazë për strukturimin, rolin, funksionet, sigurinë dhe ofrimin e shërbimeve të qendrave rinore.
- Njohja dhe përcaktimi i kompetencave të punonjësve rinorë dhe parashikimi i mbështetjes për ngritjen e programeve për formimin e punonjësve rinore dhe kualifikimin e vazhduar të tyre.

Ndryshimi i ligjit aktual lejon një zbatim më të shpejtë dhe efektiv të politikave të reja për rininë, duke ruajtur strukturat ekzistuese dhe duke garantuar që të rinjtë në Shqipëri të përfitojnë nga një kuadër më i efektiv ligjor. Ky opsion krijon mundësi të reja për zhvillimin personal, përfshirjen aktive në vendimmarrje dhe fuqizimin ekonomik të të rinjve, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Për zbatimin e ndryshimeve të propozuara në ligjin për rininë, njësitë kryesore përgjegjëse do të jenë:

- Agjencia Kombëtare e Rinisë, që do të luajë një rol kyç në zbatimin e programeve rinore, krijimin dhe mbështetjen e qendrave rinore, si dhe në sigurimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor.
- Pushteti vendor (Bashkitë), të cilat do të jenë përgjegjëse për zbatimin e programeve rinore në nivel vendor dhe për krijimin dhe mirëmbajtjen e qendrave rinore.

Pengesat e Mundshme për Zbatimin:

- Mungesa e burimeve financiare: Një nga pengesat kryesore mund të jetë pamjaftueshmëria e fondeve buxhetore për zbatimin e programeve dhe financimin e qendrave rinore.
- Kapacitetet e kufizuara njerëzore: Në disa bashki dhe institucione, mund të ketë mungesë të stafit të trajnuar për të zbatuar politikën rinore.
- Mungesa e mbështetjes nga komuniteti vendor: Mund të ketë raste kur komuniteti vendor nuk mbështet plotësisht ndryshimet e propozuara, veçanërisht në zonat rurale.

Masat që do të Ndërmerren për të arritur Qëllimet e Politikës:

- Sigurimi i financimit të qëndrueshëm: Përmes shtimit të fondeve të dedikuara për rininë, që do të mbështesë zbatimin e programeve të propozuara në ligj.
- Trajnimi i staf²it: Organizimi i programeve të trajnimit për punonjësit rinorë dhe stafin rinor të bashkive, për të përmirësuar kapacitetet për zbatimin e politikave rinore.
- Fushatat e ndërgjegjësimit: Organizimi i fushatave për të rritur ndërgjegjësimin e komunitetit për rëndësinë e politikave rinore dhe përfshirjen e të rinjve në to.
- Krijimi i mekanizmave të monitorimit: Ministria përgjegjëse për rininë dhe AKR do të ngrejë mekanizma të monitorimit për të siguruar që politikat dhe programet po zbatohen sipas planit.

Kërkesat e Përputhshmërisë dhe Zbatimit:

- Raportimi periodik: Ministria përgjegjëse për rininë do të hartojë raporte periodike nga bashkitë dhe institucionet për progresin e zbatimit të programeve rinore.
- Përcaktimi i standardeve për qendrat rinore: Vendosja e standardeve minimale për strukturat, funksionet dhe shërbimet që duhet të ofrojnë qendrat rinore në të gjithë territorin.
- Përfshirja e organizatave rinore/për të rinjtë: Për të siguruar një zbatim efektiv dhe gjithëpërfshirës, organizatat rinore do të përfshihen në procesin e monitorimit dhe zbatimit të politikave nëpërmjet verprimitarisë së tyre dhe përfaqësuesve në këshillin kombëtar rinor dhe këshillave vendorë rinorë.
- Përcaktimi i indikatorëve të performancës: Krijimi i indikatorëve të matshëm për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe ndikimin e tyre në jetën e të rinjve.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre*

Masat e Monitorimit dhe Vlerësimit:

- Për të siguruar që ndryshimet ligjore të propozuara janë duke dhënë rezultatet e pritura, Ministria përgjegjëse për rininë, e cila do të ketë rolin kryesor në mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe koordinimin me institucionet e tjera, do të ndërmerre masat e mëposhtme të monitorimit dhe vlerësimit:
- Raportimi vjetor i progresit: Institucionet përgjegjëse do të hartojnë raportin vjetor për të monitoruar zbatueshmërinë dhe arritjen e objektivave të përcaktuara në ligj në përputhje edhe me kërkesat e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029.
- Vizitat në terren: Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe bashkitë do të zhvillojnë vizita periodike në qendrat rinore për të vlerësuar cilësinë e shërbimeve dhe përputhshmërinë me standardet e vendosura.
- Konsultimet me palët e interesuara: Nëpërmjet Këshillave Vendorë Rinorë dhe Këshillit Kombëtar Rinor do të mund të merren mendime periodike lidhur me zbatueshmërinë e ligjit dhe masave të parashikuara në të.

² Lidhur me kostot e nevojshme për trajnimin e stafit, , do të bëhet një vlerësim rast pas rasti, duke qenë se ato do të varen nga faktorë të ndryshëm si kapacitete të stafit, pozicionet e tyre të punës, vendodhja e institucionit etj.

Kriteret dhe Treguesit për Matjen e Progresit:

Për të matur progresin drejt arritjes së qëllimeve të politikave, do të përdoren kriteret dhe treguesit e mëposhtëm:

- Numri i qendrave rinore të ngritura dhe funksionale.
- Numri i të rinjve të përfshirë në programet e praktikave të punës dhe talenteve rinor.
- Numri i organizatave rinore/për të rinjtë, grupeve jo formale rinore, KVR-ve të mbështetura përmes fondit grant për rininë.
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve rinore bazuar në komentet dhe vlerësimet e të rinjve dhe organizatave.
- Numri i bashkive që raportojnë për progresin e zbatimit të politikave rinore.

Masat e monitorimit dhe vlerësimit do të jenë kyçe për të siguruar që ndryshimet ligjore po zbatojnë objektivat e politikave në mënyrë efektive dhe për të bërë korrigjimet e nevojshme gjatë procesit të zbatimit. Indikatorët e performancës do të ndihmojnë në vlerësimin e ndikimit të politikave dhe në sigurimin e një qasjeje të bazuar në prova për përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit ligjor për rininë.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

në milionë lekë

	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033	2034
Faktori zbritës	1	0.9528	0.9078	0.865	0.8242	0.7853	0.7483	0.71305	0.67942	0.64737
Kosto për buxhetin – një herë	50	50	50							
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total	50	50	50							
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	50	47.641	45.39							

Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë	50	50	50							
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total	50	50	50							
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës	50	47.6 42	45.3 9							
Vlera aktuale e kostos në total	143.0 36.45									
Vlera aktuale e përfitimit në total	143.0 36.45									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	0									

Shënim: Kosto “Kosto për buxhetin – një herë”, janë kosto nga buxheti i shtetit në përputhje me PBA 2025-2027, në zbatim të politikave për mbështetjen dhe fuqizimin e të rinjve, si dhe në përputhje me objektivat për zhvillimin e tyre social dhe ekonomik, parashikuar në masën 50,000,000 lekë. Kjo kosto i dedikohet si mbështetje për kompensimin e shpenzimeve për ushqim për praktikantët e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, për mbështetjen e talenteve të reja si dhe mbështetjen dhe financimin e nismave komunitare.

Përfitime “Përfitimi për grupet e tjera – njëherë”, janë parashikuar përfituesit e shumës prej 50,000,000 lekë të cilët ndahen në kompensimin e shpenzimeve për ushqim dhe programe trajnimi për praktikantët e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës; në kompensimin e shpenzimeve për pjesëmarrje në mbledhje të të rinjve anëtarë të Këshillit Kombëtar Rinor, përfitimin e të rinjve të talentuar në fusha të ndryshme të shkencës, artit, kulturës, sportit me qëllim pjesëmarrjen në kompeticione ndërkombëtare dhe shpërblimi për rezultatet e arritura; si dhe mbështetje për nismat me impakt komunitar nga grupet joformale të të rinjve dhe këshillat vendore rinore.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 2 (i preferuar): Ndryshimi i ligjit aktual, pra i ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”.	143.036	143.036	0

Opsioni 2. Fondet e parashikuara për realizimin e objektivave të këtij ligji për një periudhë 3 vjeçare në shumën prej 50 milion lekë janë parashikuar me burim financimi nga buxheti i shtetit, në përputhje me PBA 2025-2027, në zbatim të politikave për mbështetjen dhe fuqizimin e të rinjve, si dhe në përputhje me objektivat për zhvillimin e tyre social dhe ekonomik. Kjo kosto i dedikohet si mbështetje për kompensimin e shpenzimeve për ushqim për praktikantët e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, për mbështetjen e talenteve të reja si dhe mbështetjen dhe financimin e nismave komunitare.